



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:092209
Datë: 08.08.2024
Numri i dokumentit: 06031201

K.DH.Shk II.nr. 931/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit NPT “Frutti”, me seli në Reqan, Prizren, me NUI: 810593336, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Betim Kadolli avokat nga Prizreni, kundër debitorit D.P.T “Durimi”, me seli në fshatin Buzës, Dragash, me NUI: 810289133, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1124/23 të datës 02.02.2024, me datë **07.08.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit D.P.T “Durimi”, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1124/23 të datës 02.02.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1124/23 të datës 02.02.2024, në pikën I të dispozitivit të aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit “D.P.T “Durimi”, i

paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.946/2021 të datës 22.03.2021, të nxjerrë nga Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka detyruar debitorin që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t'ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë në shumë prej 78 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1124/23 të datës 02.02.2024.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori NPT "Frutti", me seli në Reqan, Prizren, ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës nr.549 të datës 25.05.2019, me të cilin e ka urdhëruar që në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij urdhri ta përmbush detyrimin në shumën prej 1,830.00 Euro, me kamatë ligjore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbaruesit Privat, ka ushtruar prapësim debitori, me të cilin e ka kontestuar në tërësi propozimin për përmbarim, me arsyetimin se i njejtë buron nga fatura e datës 25.05.2019, për të cilën nuk mund të ngarkohet debitori, për shkak se borxhi lëndor nuk ekziston sepse debitori e ka përmbushur në tërësi obligimin që ka pasur ndaj kreditorit. Tutje ka shtuar se debitori i ka paguar atëherë punëtorit të kompanisë "Frutti" (kreditorit), Muso Cufta, shumën prej 1,200.00 Euro, duke qenë se pijet të cilat i ka sjellur ky punëtor nuk ishin sipas kërkesës së debitorit dhe sasia ishte më e madhe sesa ishte porosia, duke i mbetur fillimisht borxh pjesën tjetër të çmimit për mallin e pranuar. Ka theksuar se debitori ka biseduar me punonjësit e kreditorit që shumën prej 1,200.00 Euro e ka paguar tek punëtori i tyre, ndërsa të njëjtit e kanë

udhëzuar të mos bëjë pagesa të tjera tek ky punëtor. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, të refuzohet-hudhet poshtë si i pabazuar propozimi për përbarim i kreditorit, dhe që shpenzimet kësaj procedure t'i bartë kreditori, duke përfshirë prapësimin dhe shpenzimet e tjera eventuale të cilat do të krijohen.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se sa i përket pretendimit të debitorit se fatura e pranuar së bashku me mallin është shlyer, nuk qëndron fare sepse sikur të ishte paguar si do kërkohej përsëri pagesa, dhe nëse qenka shlyer shuma prej 1,200.00 Euro me para të gatshme, përse paska dashur që të kërkohej kthimi i mallit. Ka shtuar se fatura është dokument përbarimor sipas nenit 29 të LPP-së, pasi janë të cekura të gjitha detajet e kërkuara, ndërsa pagesa që thirret debitorit nuk është kryer dhe nuk ka asnjë provë të parashtruar në prapësim. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përbarimor i Përmbartuesit Privat. I ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale, si dhe për përgjigje në prapësim, sipas pikës 9 të rregullores së tarifave të avokatëve.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1124/23 të datës 02.02.2024, ku në pikën I të dispozitivit të aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit "D.P.T "Durimi"., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.946/2021 të datës 22.03.2021, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka detyruar debitorin që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t'ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë në shumë prej 78 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se Fatura nr.549 e datës 25.05.2019, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së

detyrimit, e njehta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin e debitorit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës të lëshuar nga kreditori, e cila faturë përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkalles e dytë bazuar ne Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili ne nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh qe *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se fatura si dokument ne sajë te cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, ka prova se është pranuar dhe nënshkruar nga debitori, prandaj konsiderohet si dokument i besueshëm. Po ashtu, fatura është dorëzuar në kopje të vërtetuar nga origjinali dhe mbanë nënshkrimin e pranimit nga ana e debitorit. Andaj, fatura enr.549/ dt.25.05.2019, është nënshkruar nga debitori dhe konsiderohet si pranim i rregullt.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti për faturën kontestuese ka përmbushur borxhin në tërësi, por te njëjtat mbesin te papabazura pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova

juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.931/24 me datë 07.08.2024

Gjyqtari

Faton Bajrami d.v.